

FJALA E DEPUTETES MILVA EKONOMI

E ENJTE 21 PRILL 2022

Të nderuar kolegë,

Në fakt, unë do të shtoj pak gjëra për këtë projektligj, sepse kolegja Bilali arriti ta shpaloste shumë mirë. Në situatën që jemi, ku po kalojmë nga një krizë tek tjetra, të gjithë ekonomistët në botë kanë filluar të mendojnë se çfarë mund të sjellin si risi në këto kushte të reja ekonomike. Pa dyshim, po përpiqen të rikonfigurojnë zinxhirin e vlerave. Pra, të gjithë po tentojnë të tërheqin drejt vendeve të tyre, ose në afërsi të caktuara gjeografike, ndërmarrje që mund t'u shërbejnë më mirë të gjithë konsumatorëve dhe të shtojnë produktivitetin. Mirëpo në këtë rrugëtim që po ndodh, pa dyshim që ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme kanë një rol të padiskutueshëm, sepse ato janë, në fakt, motori i zhvillimit të ekonomisë jo vetëm në Shqipëri, por në rajon dhe, për më tepër, në të gjithë Europën, nga ku ne kemi shumë hapje të ekonomisë në importe dhe në eksporte.

Në gjithë këtë revolucion të rikonfigurimit të zinxhirit të shkëmbimeve tregtare merr një rol të rëndësishëm edhe digitalizimi. Kështu që edhe pjesa e e-commerce-it, edhe pjesa e shërbimeve elektronike, edhe ajo punë që po bëhet për paperless në dogana, pa dyshim që janë të lidhura ngushtësisht me ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat në vendin tonë punësojnë rreth 81% të forcës së punës dhe japin një kontribut shumë të lartë në GDP-në që prodhon ekonomia shqiptare. Në fakt, nuk kemi menduar vetëm për zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve të vogla, mikro dhe të mesme, pa parë se çfarë kemi bërë në të kaluarën. Natyrisht, në të kaluarën kemi pasur një fond mbështetjeje për këto, por, nga mënyra si funksiononte, fondi nuk bënte një gërshetim të kërkuar nga nevoja e internacionalizimit të ndërmarrjeve mikro, të mesme dhe të vogla. Internacionalizimi vjen si kërkesë edhe nga programi i reformave ekonomike dhe kërkon ta mendojmë me shumë kujdes.

Kështu që në këtë ligj këtë gjë bëjmë: mendojmë me shumë kujdes se si mund t'i ndihmojmë ndërmarrjet për të kaluar në një fazë të re, që të jenë të afta të komunikojnë me ekonomitë e hapura të vendeve të rajonit dhe të atyre europiane. Duke bërë këtë proces, natyrisht që ne mendojmë se lufta në Ukrainë ka dhënë një goditje jo të vogël për ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme. Ndërkohë, ne morëm në konsideratë edhe paketën e rezistencës sociale. Në këtë paketë, falë ndërhyrjeve tona, u kemi dhënë atyre mundësinë të kenë TVSH-në dhe tatim-fitimin zero, në një kohë kur në vendet e rajonit nuk është kështu. Natyrisht, ne i kemi ndihmuar, duke u rritur pagën minimale. Ne dimë që kemi punonjës ndihmës në ndërmarrjet e vogla mikro dhe të mesme, ose punonjës në familje, të cilëve paga minimale më 1 korrik u shkon 400 mijë lekë të vjetër.

Në fakt, kjo rritje ka filluar që më 1 prill, në muajin ushtrimor. Ne i kemi ndihmuar ata me procedura të thjeshtuara të shërbimeve të tatimeve nëpërmjet procedurave që kemi hartuar për këtë qëllim. Ky është një nga drejtimet kryesore, të cilit i kemi kushtuar vëmendje. Vëmendja tjetër është drejt startup-ve, që kanë të bëjnë me idetë novatore, që duhen të mbështeten jo vetëm për ndërmarrjet mikro, të mesme dhe të vogla, por edhe për çdo ide tjetër që mund të vijë në shërbim të produktivitetit të ekonomisë së

vendit. Përveç zhvillimit të sektorit urban, vëmendja e qeverisë ka qenë edhe në sektorin rural. Herën e kaluar në Kuvend kaloi projektligji për grupet vendore të veprimit, që kishte të bënte me krijimin e grupeve të fermerëve, të cilit ishin gati të kontribuonin për zhvillimin e zonës së tyre gjeografike.

Pra, duke menduar për zonën urbane dhe për zonën rurale, për t'u dhënë shtysë iniciativave të sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, Shqipëria po kërkon të krijojë një platformë të gatshme juridike që t'i ndihmojë ndërmarrjet me incentiva financiare që të shkojnë në një nivel tjetër zhvillimi. Besoj se me këtë projektligj, përveç kësaj, kërkojmë që dhomat tona të tregtisë dhe shoqatat tona të biznesit të kenë mundësi që, kur të flasin me homologët e vendeve të rajonit, të përdorin të njëjtën gjuhë dhe të kenë mundësi të komunikojmë për të njëjtat të dhëna. Kjo është një gjë shumë e rëndësishme. Nga ana tjetër, deri tani informacionet për mbështetjen që u janë dhënë ndërmarrjeve kanë qenë informacione aty-këtu, ndërkohë që tani në këtë projektligj vjen si risi fakti që kërkohet të krijohet një regjistër, ku çdo organizatë e qeverisjes vendore apo qendrore të depozitojë të dhënat për mbështetjen që u ka bërë ndërmarrjeve deri më 31 mars të vitit pasardhës.

Kjo na e krijon më mirë të gjithë panoramën e zhvillimit që po u bëhet ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Dua të përftoj nga ky rast të falënderoj edhe kolegen tonë, zonjën Denaj, e cila në kohën e pandemisë ka bërë një punë të jashtëzakonshme, kolosale për të ndihmuar nëpërmjet dhënies së informacionit NIPT për punonjësit e regjistruar dhe të IBAN-it në bankë që të gjithë ata, që ishin punonjës të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të merrnin pagat e luftës! Të gjithë e kemi parë që në fund përpjekja rezultoi në ndihmën që iu të gjithë atyre punonjësve në këto ndërmarrje. Kjo ndodhi falë funksionimit të sistemit dhe këmbënguljes nga administrata e Ministrisë së Financave. Faleminderit shumë! Besoj se të gjithë do të jemi gati për ta miratuar këtë projektligj!